

Raport i Sekretarit të Përgjithshëm për Administratën e Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

I. Hyrje dhe prioritetet e Misionit

1. Ky raport parashtrohet në pajtim me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit, përmes së cilës Këshilli themeloi Administratën e Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), dhe kërkoi nga Sekretari i Përgjithshëm që të raportoje në intervale të rregullta lidhur me zbatimin e mandatit të saj. Në këtë raport mbulohen aktivitetet e UNMIK-ut dhe zhvillimet lidhur me to, duke filluar nga data 16 shtator 2020 deri më 15 mars 2021.
2. Prioritetet e Misionit mbesin avancimi i sigurisë, stabilitetit dhe i respektimit të të drejtave të njeriut në Kosovë dhe në regjion. Në çuarjen përpara të qëllimeve të tij UNMIK-u vazhdon angazhimin konstruktiv me Prishtinën dhe Beogradin, me të gjitha komunitetet në Kosovë, si dhe me palët vendore e ndërkombëtare. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe Forca e Kosovës (KFOR) vazhdojnë me realizimin e rolit të tyre brenda kornizës së Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit. Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX) vazhdon me praninë e tij në Kosovë në përputhje me deklaratën e presidentit të Këshillit të Sigurimit, të datës 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44) dhe me raportin e Sekretarit të Përgjithshëm, të datës 24 nëntor 2008 (S/2008/692). Agjencitë, fondet dhe programet e Kombeve të Bashkuara bashkëpunojnë ngushtë me Misionin.

II. Zhvillimet kryesore politike dhe të sigurisë

3. Zhvillimet kryesore politike u përqendruan rreth zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, të mbajtura më 14 shkurt 2021, që erdhën pas disa muajsh të turbulencave politike, të rritura edhe pas konfirmimit publik në nëntor 2020 nga Dhomat e Specializuara të Kosovës të aktakuzës kundër disa figurave të njohura politike, duke përfshirë presidentin e atëhershëm të Kosovës, Hashim Thaçi, për krime të luftës dhe krime kundër njerëzimit. Ish-presidenti më pas dha dorëheqje, dhe kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, morri detyrën e ushtrueses së presidentes më 5 nëntor. Krahas pandemisë COVID-19 dhe pasojave socio-ekonomike gjithnjë e më të mëdha të saj, zgjedhjet e shkurtit rezultuan me fitoren e Lëvizjes Vetëvendosje, ku shumica e partive të tjera të mëdha pësuan humbje. Më pas vazhduan bisedimet për krijimin e qeverisë së re dhe për zgjedhjen e presidentit të ri të Kosovës. Këto zhvillime kanë ngadalësuar dinamikën e diskutimeve brenda kornizës së dialogut të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian mes Beogradit dhe Prishtinës. Në fillim të marsit, përfaqësuesi special i Bashkimit Evropian për dialogun mes Beogradit dhe Prishtinës dhe për çështjet e tjera regjionale të Ballkanit

perëndimor mbajtën një numër takimesh të nivelit të lartë në Prishtinë dhe Beograd lidhur me krijimin e modaliteteve për vazhdimin e dialogut pasi krijimit të qeverisë së re në Prishtinë.

4. Rruga për zgjedhjet e shkurtit u hap përmes vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, të nxjerrë më 6 janar 2021, ku thuhet se krijimi i qeverisë së udhëhequr nga kryeministri Avdullah Hoti në qershor të vitit 2020 nuk ishte në përputhje me Kushtetutën për shkak të votës së pavlefshme të një deputeti, i cili më parë ishte dënuar për vepër penale me vendim të formës së prerë. Gjykata vendosi se cilido person i dënuar për vepër penale me vendim të formës së prerë gjatë tri viteve të kaluara nuk mund të jetë as kandidat për deputet në Kuvend e as të ketë ulëse të vlefshme aty. Në pajtim me këtë vendim, ushtruesja e detyrës së presidentit, Vjosa Osmani, shpërbeu Kuvendin në të njëjtën ditë, dhe caktoi datën 14 shkurt 2021 për zgjedhjet e parakohshme parlamentare.
5. Më 2 shkurt, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve certifikoi 1052 kandidatë (697 meshkuj dhe 355 femra), të cilët përfaqësonin 28 subjekte politike, që do të garonin për 120 ulëse në Kuvend. Të gjitha partitë e mëdha shqiptare vendosen të garojnë individualisht dhe nuk formuan koalicione parazgjedhore, ndërsa komuniteti serb u përfaqësua nga Lista Serbe dhe dy nisma të tjera qytetare. Në kuadër të procesit të certifikimit të kandidatëve nuk u certifikuan ata me dënime për vepra penale të shqiptuara kohëve të fundit. Pas procesit të shqyrtimit dhe të ankesave që kalon nëpër disa faza, Komisioni Qendror Zgjedhor, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa dhe Gjykata Supreme e Kosovës, 27 kandidatëve nga pesë subjekte politike ua ndaloj kandidimin për zgjedhje. Në mesin e tyre ishte edhe udhëheqësi i Vetëvendosjes, Albin Kurti, i cili ishte dënuar me vendim të formës së prerë në shtator të vitit 2018 për akuzën lidhur me lëshimin e gazit lotsjellës në sallën e Kuvendit të Kosovës në vitin 2015. Vetëvendosja dhe ushtruesja e detyrës së presidentes, Osmani, nisma e sapothemeluar qytetare e së cilës garuan në listë të përbashkët me Vetëvendosjen, kundërshtuan vendimin. Pavarësisht këtij moscertifikimi, partia e z. Kurtit e propozoi atë si kandidat për kryeministër.
6. Duke marrë parasysh se mandati i presidentit skadon më 5 maj, zgjedhjet parlamentare duhet të pasohen me zgjedhjen e presidentit të ardhshëm të Kosovës në mënyrë që të shmanget një krizë tjetër institucionale. Deri më tani, ushtruesja e detyrës së presidentes, Osmani, si pjesë e aleancës së saj me Vetëvendosjen, dhe z. Ramush Haradinaj, udhëheqësi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, publikisht kanë shprehur interesimin për postin e presidentit.
7. Zgjedhjet ishin të qeta në të gjitha 38 komunat e Kosovës. Kjo ishte hera e parë që as Bashkimi Evropian e as Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë nuk patën misionet e tyre vëzhguese për zgjedhjet në Kosovë. Bashkimi Evropian angazhoi një mision të ekspertëve zgjedhor, të përbërë prej tre personash, për të përcjellë tërë procesin zgjedhor dhe përgatitur një raport me rekomandime të parapara për fuqizimin e procesit zgjedhor. Zgjedhjet u monitoruan nga organizatat joqeveritare, partitë politike dhe përfaqësuesit e komunitetit diplomatik. Përqindja e raportuar e daljes së votuesve në zgjedhje ishte 48.78 për qind (903,386 vota), që është pak më e lartë se sa në zgjedhjet

paraprake të tetorit 2019 (44.56 për qind ose 826,916 vota). Votimi nga vendet jashtë Kosovës ka qenë dukshëm më i lartë, ku me postë janë dërguar 57,065 fletëvotime, krahasuar me 19,789, sa ishin në vitin 2019.

8. Komisioni Qendror Zgjedhor shpalli rezultatet e certifikuara më 13 mars, pas përfundimit të procesit të ankesave dhe parashtrësive. Vetëvendosja, fushata e së cilës u bazua rreth platformës me fokus në sundimin e ligjit dhe në luftën kundër korrupsionit, fitoi 50.28 për qind të votave, që përkthehen në 58 ulëse në Kuvend. Kjo është fitorja më e thellë e një partie të vetme në Kosovë që nga viti 2001. Në mesin e subjekteve të tjera politike shqiptare të Kosovës, Partia Demokratike e Kosovës doli e dyta me 17,0 për qind të votave dhe me 19 ulëse, e pasuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës me 12,73 për qind dhe 15 ulëse dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me 7,12 për qind dhe 8 ulëse.
Partia Socialdemokrate e Kosovës nuk e kaloi pragun zgjedhor prej 5 për qind. Nga 20 ulëset e garantuara për komunitetet joshumicë, Lista Serbe siguroi të gjitha 10 vendet e ndara për komunitetin serb, ndërsa 10 vendet e mbetura u shpërndan si në vijim: tre për komunitetin boshnjak, nga një për komunitetin ashkali, egjiptas dhe goran, si dhe nga dy ulëse për komunitetin rom dhe atë turk.
9. Rivotimet e pjesshme dhe anulimi i votave gjatë procesit të ankesave dhe parashtrësive rezultuan me disa ndryshime në shpërndarjen e mandateve, ku më së shumti u preken komunitete joshumicë. Pretendimet që subjektet politike të formuara së fundmi të komunitetit boshnjak dhe atij rom kanë siguruar ulëset në mënyrë jo të duhur përmes votave disproporcionalisht të larta të fituara nga komunat me shumicë serbe, janë konsideruar si të bazuara nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia dhe më pas edhe nga Gjykata Supreme, më datën 8 mars dhe përkatësisht më datën 12 mars. Këto vendime ndryshuan subjektet fituese në mesin e komunitetit boshnjak dhe atij rom. Tri vendet e rezervuara për komunitetin boshnjak u zunë nga Koalicioni Vakrat, Partia e Re Demokratike dhe nga Unioni Socialdemokrat, ndërsa nisma e re qytetare “Komuniteti i Bashkuar – Adrijana Hodžić” humbi një ulëse. Edhe pse komuniteti rom i ruajti dy ulëse, Iniciativa e Re Rome humbi një vend, të cilin e zuri Lëvizja Progresiste Rome e Kosovës.
10. Në këto zgjedhje gratë siguruan 35.83 për qind të votave ose 43 ulëse në Kuvend, nga gjithsej 120, duke kaluar kështu kuotën gjinore prej 30 për qind. Vetëvendosja kishte përqindjen më të lartë të kandidatëve të suksesshëm (23 nga 58) dhe ushtruesja e detyrës së presidentes, Osmani, fitoi numrin më të madh të votave që një kandidat për zgjedhje në Kosovë i ka fituar ndonjëherë (300,788 vota).
11. Deri në përfundim të periudhës raportuese, Vetëvendosja ka vazhduar konsultimet, posaçërisht me partitë e komuniteteve joshumicë, për formimin e koalicionit qeveritar. Më 15 mars, filloi bisedimet me të gjitha partitë politike lidhur me modalitetet për zgjedhjen e presidentit të ardhshëm. Seanca konstitutive e Kuvendit u mbajt më 22 mars, dhe zëvendëskryetari i Vetëvendosjes, Glauk Konjufca, u zgjodh kryetar i Kuvendit. Në ndërkohë, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Partia Demokratike e Kosovës, e kthyen

fokusin e tyre në reformat e brendshme partiake në përgatitje për zgjedhjet e ardhshme komunale që duhet të mbahen në tetor 2021.

12. Konfirmimi i aktakuzës së ngritur nga Zyra e Prokurorit të Specializuar nga gjyqtari i procedurës paraprake i Dhomave të Specializuara të Kosovës më 26 tetor 2020 kundër të akuzuarve të profilin të lartë, ka pasur reperkusione të thella në skenën politike. Aktakuza për krime të luftës dhe krime kundër njerëzimit është konfirmuar kundër ish-presidentit Hashim Thaçi; kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli; shefit të grupit parlamentar të Vetëvendosjes, Rexhep Selimi; dhe kundër ish-ushtresit të detyrës së presidentit të Kosovës, Jakup Krasniqi. Presidenti Thaçi, i cili dha dorëheqje, dhe të akuzuarit e tjerë u dorëzuan vullnetarisht në qendrën e paraburgimit në Hagë. Në seancat e tyre fillestare, të gjithë të akuzuarit u deklaruan si të pafajshëm.
13. Më 26 nëntor 2020, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës refuzoi propozimin e datës 24 gusht të ish-presidentit Thaçi, për ndryshimin e mandatit të Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe të Zyrës së Prokurorit të Specializuar përmes amandamentimit të Kushtetutës. Gjykata vendosi se amandamentet e propozuara do të zvogëlonin të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë, posaçërisht të drejtat e personave të përfshirë në procedura, duke përfshirë viktimat dhe dëshmitarët e mbrojtur. Gjykata po ashtu rikonfirmoi mandatin e Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe të Zyrës së Prokurorit të Specializuar deri në njoftimin e Këshillit të Bashkimit Evropian.
14. Më 6 tetor 2020, Komisioni Evropian publikoi raportin e tij vjetor për Kosovën, ku u paraqit një vlerësim i përzier i progresit, duke përfshirë edhe luftimin e korrupsionit dhe sigurimin e pavarësisë së gjyqësorit. Në raport thuhet se përparimi më i ngadalshëm vjen si rrjedhojë e jostabilitetit të vazhdueshëm politik dhe e efekteve të pandemisë COVID-19. Zhvillimet gjatë periudhës raportuese theksuan edhe më shumë këto mangësi. Më 9 tetor, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian, me arsyetimin e ndërhyrjeve të vazhdueshme politike dhe mungesës së transparencës, u tërhoqën nga procesi i monitorimit të emërimeve në Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe të kryeprokurorëve. Këshilli Prokurorial i Kosovës më pas kërkoi nga Ministria e Drejtësisë që të ndryshojë kornizën juridike për emërime të tilla me qëllim të trajtimit të këtyre shqetësimeve. Më 19 tetor, qeveria e shpërbeu departamentin kundër korrupsionit të Policisë së Kosovës, gjë që nxiti kritika të tjera të bashkësisë ndërkombëtare.
15. Gjendja e përgjithshme e sigurisë në Kosovë mbeti stabile, me disa incidente të raportuara që preknin komunitetet joshumicë. Më 17 nëntor, kryerësit e panjohur kanë djegur në Graçanicë një billboard ku përkraheshin të akuzuarit në Dhomat e Specializuara. Ky incident nxiti tensione mes komunitetit shqiptar dhe atij serb, me ç'rast kryeministri Hoti kërkoi qetësim të gjakrave. Zyra e qeverisë së Serbisë për Kosovë e Metohi ka dënuar këtë incident. Gjatë nëntorit gjithashtu janë raportuar edhe dy incidente të shlyerjes së mbishkrimeve rrugore në gjuhën serbe, një tentim për kallje të flamurit serb dhe një sulm verbal e fizik ndaj një banori serb në fshatin e përzier etnik të Kishnicës.

III. Ndikimi i pandemisë COVID-19 dhe reagimi ndaj saj

16. Gjatë periudhës raportuese u shënuar numri më i madh i infektimeve në Kosovë që nga fillimi i pandemisë COVID-19, ku më 13 nëntor 2020 u raportuan 1047 raste që njëherësh ishte edhe numri më i lartë. Meqë spitali qendror i Prishtinës po arrinte kapacitetin maksimal të shtretërve, u hapën njësi të tjera për COVID-19 në shtatë spitale regjionale në mbarë Kosovën. Pas një periudhe rënieje, numri i rasteve aktive prapë ka shënuar rritje që nga mesi i janarit. Pas shtrëngimit të kufizimeve në nëntor, autoritetet e Kosovës i lehtësuan masat më 15 janar, përkatësisht më 11 shkurt. Respektimi i përgjithshëm i kufizimeve, duke përfshirë edhe ato për tubime publike, ka qenë problematik, posaçërisht gjatë fushatës zgjedhore. Më 8 shkurt, Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë, shprehu shqetësimin për nivelin e ulët të respektimit të masave nga ana e qytetarëve, duke ftuar institucionet relevante që të sigurojnë respektim më të rreptë të masave me qëllim të parandalimit të tërhapjes së mëtejme të virusit. Një vit pas fillimit të pandemisë, agjencitë e Kombeve të Bashkuara kanë vlerësuar se ndikimi shoqëror-ekonomik i COVID-19 ka vazhduar të lë pasojë në Kosovë, përmes papunësisë në rritje, vazhdimësisë së humbjes së të ardhurave, ngecjes në arsim dhe rritjes së dhunës në familje. Deri në fundin e periudhës raportuese, në Kosovë janë raportuar 82,550 raste të COVID-19 dhe më shumë se 1824 vdekje.
17. Edhe pse gjatë periudhës raportuese përpjekjet legislative të qeverisë janë penguar nga mungesa e kuorumit parlamentar, Kuvendi i Kosovës ka miratuar më 12 tetor Projektligjin për rimëkëmbjen ekonomike – COVID-19, i cili ishte në pritje të miratimit që nga qershori 2020. Më 16 tetor, Kuvendi gjithashtu ka ratifikuar Marrëveshjen kornizë për hua me Bankën Zhvillimore të Këshillit të Evropës në vlerë prej 35 milionë euro për të përkrahur shëndetësinë publike në kohë pandemie. Qeveria e Kosovës dhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë më 20 nëntor gjithashtu nënshkruan një kontratë prej 26.5 milionësh në emër të përkrahjes buxhetore lidhur me reagimin ndaj pandemisë COVID-19. Më 29 dhjetor, një javë para shpërbërjes, Kuvendi miratoi Ligjin për ndarjet buxhetore për vitin 2021.
18. Kjo periudhë raportuese gjithashtu është karakterizuar nga fërkimet që rezultuan nga aktivitetet e institucioneve publike shëndetësore të përkrahura nga qeveria e Serbisë në zonat e Kosovës të banuara me shumicë serbe. Më 26 dhjetor, fillimi i vaksinimit në veri të Kosovës me vaksinat e siguruar nga qeveria e Serbisë nxiti reagime të fuqishme nga aktet politike në Prishtinë. Qeveria e Kosovës filloi një hetim lidhur me dhënien e vaksinave në veri të Kosovës dhe përputhshmërinë e saj me protokollet e shëndetësisë publike në Kosovë. Si reagim ndaj kësaj, punëtorët shëndetësorë të sistemit të përkrahur nga Beogradi, më 25 janar mbajtën një protestë në Mitrovicë të Veriut. Institucionet e mbështetura nga Beogradi në ndërkohë ndërprejnë vaksinimet në veri të Kosovës, duke iu ofruar banorëve të Kosovës vaksinimin në lokacione në Serbi.
19. Gjatë pandemisë COVID-19, UNMIK-u dhe agjencitë, fondet e programet e Kombeve të Bashkuara vazhduan me punë, njëkohësisht duke zbatuar masat e zvogëlimit të rrezikut për punonjësit e tyre, duke përfshirë punën nga shtëpia dhe bashkërendimin e përpjekjeve për

sigurimin e mirëqenies së punonjësve, vazhdimësinë e punës, si dhe përkrahjen për autoritetet dhe komunitetet vendore. UNMIK-u ka instaluar pajisjet dhe objektet e nevojshme, si dhe personelin e specializuar për trajtimin e punonjësve të Kombeve të Bashkuara dhe të familjarëve të tyre të ngushtë, përveç për rastet më të rënda, për të cilat kërkohet evakuimi mjekësor. Në Mision vazhduan punën dy ekiye emergjente mjekësore për ofrimin e ndihmesës punonjësve dhe familjarëve të tyre të ngushtë. Brenda Misionit është funksional një laborator për kryerjen e testeve RTPCR (reagimi i kthyesëm transkriptues i zinxhirit polimerazë) me përkrahjen e stafit shtesë të përkohshëm. Deri në përfundimin e periudhës raportuese, gjithsej janë regjistruar 141 raste të konfirmuara të COVID-19 në mesin e punonjësve të Kombeve të Bashkuara dhe familjarëve të tyre të ngushtë në Kosovë, ku përfshihen 117 raste në mesin e punonjësve të UNMIK-ut dhe familjarëve të tyre të ngushtë (me 24 raste ende aktive) dhe 24 raste në mesin e punonjësve të ekipit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe familjarëve të tyre të ngushtë (me 4 raste ende aktive).

20. Në reagimin ndaj COVID-19, UNMIK-u, në bashkëpunim të ngushtë me ekipin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, vazhdoj përkrahjen e institucioneve të shëndetit publik dhe të popullatës së Kosovës, posaçërisht të atyre nga komunitetet e cënueshme. Në kohën kur shumica e aktiviteteve të tij programatike janë përshtatur me qëllim të përqendrimit në nevojat lidhur me pandeminë, Misioni u shpërndau pako ushqimore e higjienike komuniteteve të cënueshme dhe vazhdoj me mobilizimin e përkrahjes për gratë dhe vullnetarët e ri në ofrimin e pajisjeve personale mbrojtëse. UNMIK-u gjithashtu mbështeti Zyrën e Komisionerit për Gjuhë, brenda Zyrës së Kryeministrit, në përkthimin e materialeve informuese për publikun lidhur me COVID-19 në gjuhët e komuniteteve joshumicë, siç është gjuha serbe dhe ajo turke. Misioni dhe ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, udhëhoqën shpërndarjen e informatave të verifikuara të shëndetit publik me qëllim të kundërshtimit të keqinformimit, duke përfshirë edhe shpërndarjen e tyre në mediat shoqërore. Gjithashtu, në bashkëpunim me autoritetet, janë realizuar disa fushata shumëgjuhësore për ndërgjegjësimin e qytetarëve, duke përdorur mediat shoqërore, instalacionet në ambiente të hapura dhe shpalljet e shërbimit publik me qëllim të promovimit të respektimit të masave për ndalimin e përhapjes së virusit.
21. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) dhe agjencitë e tjera kanë vazhduar me përkrahjen e institucioneve të shëndetit publik, duke përfshirë edhe përmes angazhimit të misioneve teknike dhe ofrimit të ekspertëve, fuqizimit të përcjelljes, kontrollit të infeksionit dhe kapaciteteve testuese, si dhe blerjes së pajisjeve esenciale. Po ashtu, ka filluar aplikimi i një mekanizimi inovativ i grumbullimit të të dhënave në terren për emergjencat të shëndetit publik (Go.Data). Gjithashtu, është fuqizuar zbatimi i procedurave në strehimoret e viktimave të dhunës në familje së bashku me udhëzimet për trajtimin e emergjencave të shëndetit publik. Komisioni për vaksinim kundër COVID-19, i themeluar nga Ministria e Shëndetësisë, OBSh-ja dhe Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara (UNICEF) kanë përkrahur zhvillimin e planit për shpërndarjen e vaksinave dhe kanë ndihmuar qeverinë në krijimin e ndërlidhjes me Aleancën Globale për Vaksina dhe Imunizime (GAVI), si dhe në sigurimin e qasjes në Përkushtimin për Tregun e Avancuar të COVAX. COVAX, i cili

bashkëdrejtohet nga Koalicioni për Inovacione në Gatishmërinë ndaj Epidemive, GAVI dhe OBSH, së bashku me partnerin kryesor zbatues UNICEF-in, i kanë ndarë Kosovës gjithsej 100800 doza të vaksinave në kuadër të raundit të parë të shpërndarjeve, të cilat do të dorëzohen gjatë muajit maj. UNICEF-i do të vazhdojë bashkëpunimin me GAVI lidhur me shpërndarjen e dozave të mbetura deri në arritjen e 20 për qindëshit të popullatës (360200 njerëz dhe 720000 doza). Gjatë periudhës raportuese, ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, i udhëhequr nga Koordinatori për zhvillim, ka vazhduar së zbatuari planin e tij të reagimit shoqëror-ekonomik, duke mobilizuar më shumë se 20 milionë \$ në formë të ndihmës dypalëshe dhe shumëpalëshe, duke përfshirë edhe 2.5 milionë \$ përmes fondit shumëpartnerësh të Mirëbesimit të Kombeve të Bashkuara për reagim ndaj COVID-19 dhe rimëkëmbje.

IV. Kosova veriore

22. Zhvillimet politike në veri të Kosovës u orientuan rreth zgjedhjeve të jashtëzakonshme komunale në Mitrovicë të Veriut dhe në zgjedhjet parlamentare të 14 shkurtit. Pas pesë muajsh vonese për shkak të COVID-19, organizmi i zgjedhjeve komunale në Mitrovicë të Veriut u bë më 29 nëntor. Lista Serbe fitoi mbi 90 për qind të votave, ku pjesa e mbetur e votave u nda mes Vetëvendosjes, Partisë Demokratike të Kosovës dhe një kandidati të pavarur serb. Lista Serbe gjithashtu siguroi fitore të bindshme në zgjedhjet e përgjithshme të 14 shkurtit, duke fituar më shumë se 78 për qind të votave në të katër komunat e veriut të Kosovës.
23. Si zgjedhjet komunale, ashtu edhe ato të përgjithshme përfunduan pa ndonjë incident të madh. Pavarësisht kësaj, politikanët shqiptarë dhe ata serbë që konkurronin kundër Listës Serbe vazhdojnë të ballafaqohen me sfida për organizimin e lirshëm të fushatës në veri. Më 30 janar, para fillimit zyrtar të fushatës për zgjedhjet e 14 shkurtit, një vizitë e ushtrueses së detyrës së presidentes, Osmani, dhe udhëheqësit të Vetëvendosjes, Albin Kurti, në lagjen etnikisht të përzier të Kodrës së Minatorëve në Mitrovicë të Veriut u ndërpre nga një grup i serbëve që brohorisnin “kjo është Serbi”. Kjo vizitë, posaçërisht nga ushtruesja e detyrës së presidentes, është kritikuar nga disa parti shqiptare si e paraparë për fushatë zgjedhore, si dhe nga politikanët serbë, ku udhëheqësi i Listës Serbe, Goran Rakiq, e përshkroi si provokim. Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, e dënoi vizitën dhe theksoi nevojën për “ruajtjen e paqes”.
24. Me rastin e trevjëtorit të vrasjes së politikanit serb Olliver Ivanoviq, më 16 janar u bë përkujtimi i tij në mënyrë paqësore në Mitrovicë të Veriut. Procedurat gjyqësore për vrasjen e tij kanë vazhduar, ku Zyra e Prokurorit Special më 11 nëntor ka ngritur aktakuza të reja kundër gjashtë të pandehurve, pasi që Gjykata e Apelit ktheu aktakuzën e mëparshme pas ankesave të avokatëve mbrojtës. Gjashtë të pandehurit akuzohen për vepër penale të vrasjes së rëndë. Në seancën fillestare për akuzën e re të mbajtur më 5 shkurt, gjashtë të pandehurit u deklaruan të pafajshëm për akuzën e vrasjes, ndërsa dy prej tyre u deklaruan si fajtor për akuzën e armëmbajtjes. Me kërkesë të prokurorit special, më 23 shkurt, gjykatësi i

procedurës paraprake tërhoqi fletarrestin kundër njërit prej dy të pandehurve që ende janë në arrati.

V. Normalizimi i marrëdhënieve mes Beogradit e Prishtinës

25. Delegacioni i Beogradit dhe ai i Prishtinës, të udhëhequra nga kryenegociatorët e tyre, mbajtën tri raunde të bisedimeve në nivel të ekspertëve për çështjet lidhur me pretendimet financiare dhe pronësore. Këto bisedime u mbajtën me ndërmjetësimin e Miroslav Lajčák, përfaqësues special i Bashkimit Evropian për dialogun mes Beogradit dhe Prishtinës dhe çështjet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Përkundër gatishmërisë së palëve për t'u takuar dhe diskutuar çështjet e pazgjidhura, Beogradi dhe Prishtina ende nuk kanë dakorduar qëndrimet e tyre, duke përfshirë edhe qëndrimet për themelimin e asociacionit/bashkësisë së komunave me shumicë serbe në Kosovë. Në deklaratimet e tyre të ndara për mediat pas bisedimeve të raundit të parë dhe të dytë, më 17 shtator, përkatësisht 29 tetor, palët vërtetuan se kishin pikëpamje të kundërta për mënyrën e zgjidhjes së pretendimeve financiare dhe çështjeve pronësore, ku Beogradi ngulmonte që asociacioni/bashkësia të jetë pjesë e diskutimeve. Tensionet u përshkallëzuan në nëntor lidhur me shkeljen e Marrëveshjes për lirinë e lëvizjes dhe rregullimin e vizitave zyrtare, kur si Beogradi, ashtu edhe Prishtina nuk i lejuan vizitat e zyrtarëve të njëri-tjetrit në zonat të ndryshme në Serbi dhe Kosovë në kohën kur mbetjet mortore po zhvarroseshin në vendet afër Rashkës në Serbi. Këto ngjarje quan në thirrje të Bashkimit Evropian për autoritetet e Kosovës që të respektojnë zotimet e bëra në kuadër të dialogut.
26. Pas takimit të tyre të fundit më 10 dhjetor, dhe duke marrë parasysh qëndrimet e kundërta dhe zgjedhjet e jashtëzakonshme në Kosovë, palët u pajtuan që diskutimet t'i vazhdojnë gjatë vitit 2021. Pas zgjedhjeve, z. Lajčák udhëtoi në Prishtinë dhe Beograd prej datës 1 deri më 3 mars për t'i diskutuar modalitetet për raundin e ardhshëm të bisedimeve. Në Prishtinë, z. Kurti, deklaroi se pas marrjes së mandatit, fokusi kryesor i qeverisë së tij do të jetë trajtimi i çështjeve urgjente socio-ekonomike dhe të sundimit të ligjit. Megjithatë, ai pranoi rëndësinë e dialogut dhe nevojën që i njëjti të jetë “i bazuar në parime dhe mirë i përgatitur”. Në Beograd, udhëheqësia serbe ritheksoi gatishmërinë e saj për vazhdimin e dialogut, duke vënë në pah rëndësinë e zbatimit të plotë të marrëveshjeve të nënshkruara. Gjatë periudhës raportuese, Beogradi gjithashtu kundërshtoi nocionin e “njohjes së ndërsjellë” të promovuar nga Prishtina si rezultat kryesor i çfarëdo marrëveshjeje gjithëpërfshirëse.
27. Më 14 dhjetor, Sistemi për Transmisionin e Energjisë dhe Operatorët e Tregut i Kosovës mori përgjegjësinë nga Rrjeti Elektrik i Serbisë për sistemin e transmisionit në veri të Kosovës. Ky ishte hap domethënës përpara në zbatimin e Marrëveshjes për energji të vitit 2013, të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, ku Kosova u shpall si zonë e pavarur rregullatore pas hyrjes së Sistemit të Transmisionit të Energjisë dhe Operatorit të Tregut të Kosovës në Rrjetin Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Energjisë më 30 qershor 2020.

28. Në kuadër të zotimeve të dakorduara nga Beogradi e Prishtina, me ndërmjetësimin e Shteteve të Bashkuara më 4 shtator 2020, autoritetet serbe zhvendosen zyrtarët policorë dhe të doganave në objektin e integruar në vendkalimin e Merdarës (Porta 3), të ndërtuar me përkrahjen e Bashkimit Evropian. Ky ishte gjithashtu hap i rëndësishëm në zbatimin e “Protokollit teknik të MIK”, të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian për menaxhimin e përbashkët të vendkalimeve. Përveç kësaj, dhe në përputhje me zotimet e 4 shtatorit, ish-ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporë e Kosovës, Meliza Haradinaj-Stublla, dhe ministri i Jashtëm i shtetit të Izraelit, Gabi Ashkenazi, nënshkruan marrëveshjen për krijimin e marrëdhënieve diplomatike gjatë një ceremonie virtuale, të mbajtur më 1 shkurt. Zëdhënësi i Shërbimit për Punë të Jashtme të Evropës, duke iu referuar themelimit të përfaqësisë së Kosovës në Jerusalem sipas marrëveshjes, rikujtoi zotimet e Kosovës për integritet në BE dhe ftoj Kosovën që të veprojë në përputhje me këto zotime. Ministri i Jashtëm i Serbisë, Nikolla Sellaković, shprehu pakënaqësinë me marrëveshjen. Më 14 mars, Kosova hapi përfaqësinë e saj zyrtare në Jerusalem. Brenda në Kosovë, një parti e madhe e turqve të Kosovës gjithashtu shprehu shqetësim se përmes këtij vendimi shkeleshin rezolutat relevante të Këshillit të Sigurimit.
29. Më 30 tetor, presidenti i Serbisë, kryeministri i Shqipërisë dhe ai i Maqedonisë së Veriut mbajtën një telekonferencë për të diskutuar bashkëpunimin regional brenda kornizës së nismës për “mini-shengen” me qëllim të lehtësimit të lirisë së lëvizjes të promovuar nga tri vendet. Autoritetet e Kosovës u ftuan, por nuk morën pjesë.

VI. Kthimet, pajtimi, trashëgimia kulturore dhe marrëdhëniet mes komuniteteve

30. Gjatë periudhës raportuese, Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) regjistroi 273 kthime vullnetare nga pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, të cilët kanë qenë të zhvendosur jashtë Kosovës. Në mesin e të kthyerve janë 133 femra dhe 140 meshkuj (223 serbë, 36 ashkali, 10 romë dhe 4 shqiptarë). Tani, gjithsej numri i të personave të zhvendosur nga komunitete joshumicë që kanë gjetur zgjidhje të qëndrueshme në Kosovë që nga viti 2000 ka arritur numrin prej 28819, ku përfshihen 14153 femra dhe 14666 meshkuj (12429 serbë, 7706 egjiptas dhe ashkali, 4000 romë, 1878 boshnjak, 1464 goranë, 1298 shqiptarë, 21 malazez, 19 turq dhe 4 kroatë). Ende mbesin 15781 persona të zhvendosur brenda Kosovës (7268 femra dhe 8513 meshkuj), si dhe 69627 persona me nevoja të lidhura me zhvendosje në Ballkanin Perëndimor, nga përafërsisht 200000 persona të zhvendosur nga Kosova që jetojnë në regjion, ku shumica prej tyre gjenden në Serbi.
31. Në kuadër të “procesit të Shkupit”, iniciativë kjo regjionale e organizuar nga UNHCR dhe OSBE, më 13 nëntor u takua grupi punues teknik për zgjidhjet e qëndrueshme, i përbërë nga përfaqësuesit e Beogradit, Podgoricës, Prishtinës dhe Shkupit. Ky takim u organizua për të vlerësuar progresin dhe sfidat në fushën e sigurisë, çështjeve pronësore, menaxhimit të të dhënave, dokumenteve të gjendjes civile dhe në fushën e planifikimit të zgjidhjeve. Pjesëmarrësit diskutuan për mënyrën e ecjes përpara në zbatimin e “Dokumentit koncept për planifikimin e zgjidhjeve” lidhur me zgjidhjet e qëndrueshme

për personat e zhvendosur nga Kosova dhe brenda saj, i miratuar në nëntor të vitit 2019, duke marrë parasysh përvojat regjionale të ashtuquajturit “Proces i Sarajevës”. Ata gjithashtu kërkuar përpjekje shtesë për trajtimin e incidenteve që prekin të kthyerit, për zgjidhjen e çështjeve të pazgjidhura pronësore, përsheptimin e ndarjes së trojeve dhe të zgjidhjeve të tjera praktike për të zhvendosurit, si dhe theksuan rëndësinë e bashkëpunimit regional për arritjen e përparimit të mëtejshëm.

32. Personat e zhvendosur brenda vendit, të kthyerit, personat në rrezik të shndërrimit në apatridë dhe të mbijetuarit e dhunës në familje e të asaj gjinore vazhduan të marrin përkrahje përmes projektit të Fondit shumëpartnerësh të Mirëbesimit të Kombeve të Bashkuara për reagim ndaj COVID-19 dhe rimëkëmbje. Në kuadër të projektit, të zbatuar bashkërisht nga UNHCR, Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) dhe Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizim të Gruas (UN-Women), përfituesit kanë marrë përkrahje psikologjike, juridike dhe të gjenerimit të të ardhurave me qëllim të rimëkëmbjes nga efektet e pandemisë.
33. Përpjekjet për nxitjen e kthimeve të qëndrueshme vullnetare gjithashtu kanë vazhduar. Më 12 janar, 87 familje të zhvendosura serbe që banonin në katër qendra kolektive në komunën e Shtërpçës, kaluan në banesat e reja të ndërtuara në të njëjtën komunë. Kjo u mundësua përmes projektit për banim social, të financuar nga Bashkimi Evropian dhe realizuar nga Këshilli Danez për Refugjatët e Ministria për Komunitete dhe Kthime. Po ashtu, edhe IOM-i mbështeti reintegrimin social dhe ekonomik të 42 familjeve në gjashtë komuna. Në nëntor të vitit 2020, UNMIK-u në bashkëpunim me Ministrinë për Komunitete dhe Kthime ndihmoi në rifillimin e transportit humanitar për të kthyerit serbë në fshatin Bablak, të komunës së Ferizajt, si dhe në komunën e Graçanicës dhe atë të Shtërpçës.
34. Migrimi në Kosovë ka vazhduar të rritet, me ç'rast janë regjistruar gjithsej 1087 persona të ardhur, nga të cilët 448 kanë parashtruar kërkesën për azil. UNHCR-ja siguroi që të gjithë azilkërkuesit të marrin ndihmë juridike dhe psikologjike falas, si dhe ka përkrahur autoritetet e Kosovës në sigurimin e kushteve të duhura të pranimit. Me mbështetjen e IOM-it, autoritetet e Kosovës gjithashtu janë duke hapur Qendrën e Përkohshme për Akomodim dhe Regjistrim të emigrantëve në fshatin Vranidoll.
35. Këshilli për Implementim dhe Monitorim, i cili mbikëqyrë zonat e posaçme të mbrojtura rreth lokacioneve fetare, u takua më 9 nëntor 2020 për të diskutuar problemin e vazhdueshëm të ndërtimit të rrugës transit për Mal të Zi përmes zonës së posaçme të mbrojtur të manastirit të Deçanit. Këshilli arriti një marrëveshje, ku parashihet ndërtimi i njëkohshëm i rrugës anashkaluese dhe i një rruge alternative lokale, e cila do të kalonte nëpër zonën e posaçme të mbrojtur. Marrëveshja që u ndërmjetësua nga përfaqësuesi i Italisë, ka për qëllim promovimin e marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve dhe zhvillimin ekonomik në komunë, ndërsa zbatimi i saj do të përcillet nga Këshilli për Implementim dhe Monitorim me përkrahje të KFOR-it. Përfaqësuesit e manastirit, si dhe autoritetet komunale e ato qendrore e mirëpritën këtë marrëveshje.

36. Autoritetet e Kosovës dhe organizatat ndërkombëtare vazhduan me mbështetjen e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas në pajisjen me dokumentacion personal dhe në zgjidhjen e çështjeve të gjendjes civile me qëllim të mundësimit të qasjes së tyre në shërbime publike. UNHCR-ja ofroi ndihmë juridike 103 individëve (61 femra dhe 42 meshkuj) për lehtësimin e regjistrimit të tyre civil, ka mundësuar kthimin vullnetar të 125 personave të kthyer dhe të zhvendosur (56 femra dhe 69 meshkuj) nga komunitetet joshumicë që do të përfitojnë nga ndihma sociale, të drejtat pronësore dhe të pensioni; si dhe ka ofruar ndihmesë psikologjike 59 të mbijetuarve nga dhuna gjinore (53 femra dhe 6 meshkuj). Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Kosovës ka dhënë 585 bursa në shumë prej 300 euro secila nxënësve romë, ashkali dhe egjiptas të shkollës së mesme për vitin aktual shkollor. Gjatë periudhës në shqyrtim, nuk ka pasur kontribute në fondin e mirëbesimit të Kombeve të Bashkuara në përkrahje të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas të Kosovës, të cilët janë prekur nga helmimi me plumb, duke e lënë kështu fondin me resurse të pakta për mbështetjen e nevojave të tyre urgjente.

VII. Sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut

37. Gjykatat e Kosovës nxorën aktgjykime për disa raste të korrupsionit dhe të krimeve të luftës. Më 7 tetor, është ngritur aktakuza kundër ish-kryetarit të komunës së Kaçanikut, Xhabir Zharku, ku ai akuzohet për keqpërdorim të detyrës apo autoritetit zyrtar, me pretendimet se ai ka lejuar ndërtime pa leje në parcela kadastrale në pronësi shoqërore. Në nëntor, Gjykata Supreme e Kosovës, konfirmoi dënimet e burgimit me kusht, të shqiptuara nga Gjykata e Apelit, kundër të gjithë individëve të akuzuar në rastin e ashtuquajtur “Pronto”, ku përfshiheshin zyrtarë të lartë të Partisë Demokratike të Kosovës. Ngjashëm me këtë, në janar, Gjykata e Apelit, vërtetoi aktakuzën kundër ish-ministrit të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Nenad Rikallo, dhe të punonjësve të tjerë të ministrisë për keqpërdorim të detyrës apo autoritetit zyrtar. Më 24 shkurt, Prokuroria e Kosovës dhe Policia e Kosovës realizuan një operacion në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Prishtinë dhe në katër lokacione të tjera në Kosovë, i cili rezultoi me arrestimin e 12 personave, duke përfshirë 10 zyrtarë të ministrisë, nën akuza të korrupsionit dhe akuza të tjera. Prokuroria Speciale e Kosovës gjithashtu ngriti akuzë për keqpërdorim të detyrës apo autoritetit zyrtar kundër ish-shëfit të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, drejtorit të Departamentit për shtetësi, azil dhe emigracion në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe kundër drejtorit të Drejtorisë për migrim dhe të huaj në policinë kufitare të Kosovës, lidhur me dëbimin e gjashtë shtetasve turq në mars të vitit 2018. Qeveria miratoi strategjinë e re kundër korrupsionit dhe planin e veprimit 2021-2025, e cila pritet të miratohet nga Kuvendi i Kosovës. Po ashtu, në Kuvend janë dërguar edhe propozimamandamentet në Ligjin për financimin e subjekteve politike, dhe pritet miratimi i tyre.

38. Gjatë të njëjtës periudhë, disa të pandehur të profilit të lartë janë shpallur të pafajshëm për akuzat lidhur me keqpërdorimin e detyrës apo autoritetit zyrtar, siç janë 12 të pandehurit në të ashtuquajturin “rasti i veteranëve”, ku përfshihej ish-kryeministri, Agim Çeku, ish-ministri i Mbrojtjes, Rustem Berisha, dhe deputeti i Kuvendit, Shkumbin Demaliaj.

Organizatat vendore të shoqërisë civile vazhduan të shprehin shqetësim rreth “drejtësisë së politizuar” dhe dënimeve të buta të gjykatave në rastet e profilin të lartë. Në dy raporte të ndryshme, Instituti i Kosovës për Drejtësi vuri në pah sfidat në ndjekjen penale të korrupsionit të nivelit të lartë, numrin e vogël të aktakuzave të ngritura nga prokuroria dhe numrin e lartë të rasteve të pazgjidhura.

39. Seancat dëgjimore janë mbajtur për katër raste të krimeve të luftës, ku përfshihen krimet kundër popullatës civile që pretendohet të jenë kryer gjatë luftës në Kosovë, duke përfshirë edhe dhunimin. Më 6 nëntor, Departamenti i posaçëm i Gjykatës së Apelit, hodhi poshtë vendimin për shpallje fajtor kundër Sami Lushtakut, ish-kryetarit të komunës së Skenderajt, lidhur me ikjen e tij nga paraburgimi kur po gjykohej në rastin e ashtuquajtur “rasti i Drenicës”, për shkak të skadimit të afatit të parashkrimit të ndjekjes penale. Më 1 dhjetor, Departamenti i posaçëm i Gjykatës së Apelit vërtetoi dënimin për krime të luftës të ish-pjesëtarit rezervë të forcave policore të Jugosllavisë, por e zvogëloi dënimin nga 22 në 11 vite burg, gjë që nxiti protesta nga banorët e Krushës së Madhe. Më 23 dhjetor, policia e Kosovës arrestoi një individ që dyshohej se ka kryer krime të luftës kundër popullatës civile në vitin 1999 në Pejë. Më 24 dhjetor, një ish-pjesëtar tjetër i policisë së Jugosllavisë është dënuar me gjashtë vjet burg, ndërsa më 11 shkurt, një ish-pjesëtar rezervë i policisë së forcave serbe është dënuar me 12 vjet. Që të dy u dënuan për krime të luftës kundër popullatës civile.

40. Kosova vazhdojë të ndjekë penalisht individët që dyshohen se kanë marrë pjesë në luftëra të huaja dhe terrorizëm. Më 18 dhjetor, gjykata themelore në Prishtinë e dënoi një mashkull me 18 muaj burg lidhur me akuza për terrorizëm dhe kërcënim të përfaqësuesit të Kosovës në Francë, pasi që ky i fundit ripostoi në Twitter artikullin e gazetës franceze që përmbante karikaturën e profetit Muhamed. Më 20 dhjetor, dy meshkuj u akuzuan nën akuzën e tentimudhëtimit në Republikën Arabe të Sirisë për pjesëmarrje në luftëra të huaja, derisa më 11 shkurt 2021, dy të pandehur të tjerë janë shpallur të pafajshëm përmes aktgjykimit të shkallës së parë lidhur me pretendimin se kanë udhëtuar në Republikën Arabe të Sirisë për qëllime të terrorizimit. Më 24 dhjetor, Zyra e Prokurorisë Speciale ngriti aktakuzë kundër një individi për tentim të organizimit të grupit terrorist apo të pjesëmarrjes në të. Në përpjekjet për trajtimin e kërcënimeve terroriste, qeveria e Kosovës ka miratuar dokumentin “Vlerësimi i rrezikut nacional nga shpëlarja e parave dhe financimi i terrorizimit”, i hartuar me përkrahjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), ku përfshihet analiza e rreziqeve, kërcënimeve dhe cenueshmërive të ndërlidhura.

41. UNMIK-u vazhdoi të përcjellë për së afërmi dhe të raportoj për implikimet e pandemisë COVID-19 në të drejtat e njeriut, duke u fokusuar në ndikimin e saj joproporcional në komunitetet joshumicë dhe në personat në situata të cenueshme. Pandemia dhe masat kufizuese të lidhura me të kanë vazhduar të ndikojnë në gëzimin e të drejtave të njeriut lidhur me lirinë e lëvizjes, grumbullimin paqësor dhe fenë; të drejtat në jetë dhe shëndet, si dhe në të drejtat ekonomike e sociale. Ministria e Shëndetësisë e Kosovës dhe Instituti i Kosovës për Shëndet Publik vazhduan të publikojnë informatat e fundit për gjendjen rreth pandemisë COVID-19, kryesisht në gjuhën shqipe, duke ua vështirësuar kështu qasjen në

informatë komuniteteve joshumicë dhe rrjedhimisht duke ua shkelur të drejtat e tyre gjuhësore. Me rastin e shënimit të Ditës së të Drejtave të Njeriut më 10 dhjetor, Përfaqësuesi Special rikonfirmoi zotimin e Kombeve të Bashkuara për të mbështetur autoritetet e Kosovës dhe palët e tjera me interes në përpjekjet e tyre për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut për të gjithë njerëzit në Kosovë, si dhe ftoi të gjitha palët që të drejtat e njeriut t'i vendosin në thelb të reagimit ndaj pandemisë dhe të përpjekjeve për rimëkëmbje në mënyrë që të sigurohemi se komunitetet dhe personat në situata të cenueshme të mos lihen anash.

42. Më 30 shtator, qeveria e Kosovës miratoi propozimamamentin në Ligjin për liritë fetare, i cili pasi të aprovet nga Kuvendi i Kosovës, do të fuqizoj liritë fetare, duke ua mundësuar komuniteteve fetare të fitojnë statusin e subjektit juridik. Më 26 nëntor, sipas Kodit të ri për Drejtësinë e të Miturve, Ministria e Drejtësisë shpalli tri akte nënligjore që kanë për qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mbrojtjes, rehabilitimit dhe procesit të riintegritetit të të miturve të privuar nga liria. Këto akte nënligjore janë hartuar me ndihmesën e UNMIK-ut në partneritet me Fondin për Fëmijë të Kombeve të Bashkuara dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare e me Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Minimumin e Standardeve për Administrimin e Drejtësisë së të Miturve (Rregullat e Pekinit).
43. Në shkurt të vitit 2021, një gazetar investigativ është sulmuar brutalisht në Prishtinë, ndërsa ekipet televizive të Beogradit janë penguar të vijnë në veri të Kosovës gjatë zgjedhjeve. Si reagim ndaj këtyre incidenteve, Përfaqësuesi Special theksoi rëndësinë e sigurimit të mjedisit të qetë dhe stimulues për gazetarët e të gjitha komuniteteve, dhe thirri për ringjallje të përpjekjeve në sigurimin e ushtrimit të pakufizuar të lirisë së mediave dhe të drejtës për informatë në Kosovë.
44. UNMIK-u vazhdoi me mbështetjen e përpjekjeve në përcaktimin e fatit të 1640 personave që ende janë të zhdukur që nga lufta në Kosovë. Më 16 shtator, UNMIK-u mori pjesë në takimin e Grupit punues të Prishtinës dhe Beogradit për persona të zhdukur lidhur me ngjarjet në Kosovë. Takimi u fokusua në identifikimin e varrezës potenciale masive në Kizhevak të Serbisë, të cilën UNMIK-u më pas e vizitoi më 4 dhjetor. UNMIK-u gjithashtu përkrahi Qendrën e Resurseve për Persona të Zhdukur në shpërndarjen e pakove ushqimore dhe higjienike anëtarëve të familjeve të personave të zhdukur nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

VIII. Gratë, paqja dhe siguria

45. Komisioni qeveritar i Kosovës përgjegjës për verifikimin dhe njohjen e statusit të të mbijetuarve të dhunës seksuale të lidhur me konfliktin ka pranuar 111 aplikacione, duke e çuar numrin e përgjithshëm të aplikacioneve të pranura që nga themelimi i tij në shkurt të vitit 2018 në 1414. Deri më tani, 912 aplikantëve (880 gra dhe 32 burra) u është dhënë statusi i të mbijetuarit, ndërsa 210 (180 gra dhe 30 burra) janë refuzuar. Në shkurt, Gjykata themelore në Prishtinë e udhëzoi komisionin për të shqyrtuar, për herë të parë, vendimin e e tij për të refuzuar një kërkesë për statusin e të mbijetuarit, duke hapur rrugën për të mbijetuarit të kundërshtojnë vendimet e komisionit dhe të realizojnë të drejtën e tyre për mjete efektive juridike. Në shtator të vitit 2020, UNMIK-u filloi një iniciativë për të mbështetur fuqizimin ekonomik dhe të drejtat e të mbijetuarve të dhunës seksuale të lidhur me konfliktin, si dhe dhunën seksuale dhe atë në baza gjinore nga të gjitha komunitetet në Kosovë, duke përfshirë të drejtën e tyre në mjete juridike të efektshme dhe në kompensim. Kjo nismë u siguron rreth 150 të mbijetuarve qasje në trajnim profesional, këshillim psikosocial, ndihmë ligjore dhe kujdes mjekësor.
46. Më 17 nëntor, UNMIK-u, në partneritet me UN-Women dhe Bashkimin Evropian, bashkoi 24 gra udhëheqëse nga të gjitha komunitetet dhe përfaqësuesit ndërkombëtarë në një ngjarje në internet, gjatë së cilës gratë udhëheqëse bënë thirrje për pjesëmarrje të barabartë dhe të plotë të grave në strukturat e pushtetit dhe proceset e paqes, përfshirë Dialogun e mbështetur nga Bashkimi Evropian midis Beogradit dhe Prishtinës. Në mënyrë të ngjashme, UN-Women mbështetën Lobin Rajonal të Grave për Paqe, Siguri dhe Drejtësi në Evropën Juglindore në organizimin e një konference më 15 dhjetor, që bashkoi 45 gra udhëheqëse nga Ballkani Perëndimor, përfshirë Beogradin dhe Prishtinën, në një dialog konstruktiv dhe progresiv mbi pjesëmarrjen domethënëse të grave në proceset e paqes.
47. Për të shënuar 20 vjetorin e Rezolutës 1325 (2000) të Këshillit të Sigurimit të KB-së për gratë, paqen dhe sigurinë, UNMIK-u, së bashku me përfaqësuesit e pranive të tjera ndërkombëtare në Kosovë, ndërmori një sërë fushatash të komunikimit strategjik dhe mediave sociale për të rritur ndërgjegjësimin lidhur me rolin të grave në Kombet e Bashkuara, dhe për të promovuar gratë, paqen dhe agjendën e sigurisë. Me ndihmën e Grupit shumëpalësh për siguri dhe çështje gjinore, i cili kryesohet nga UN-Women dhe përfshin UNMIK-un, u zhvilluan aktivitetet në mbështetje të fushatës globale 16 Ditët e Aktivizmit kundër dhunës me baza gjinore. Dokumentari i përgatitur nga UNMIK-u "Nuk është prona jote" u shfaq në programet televizive në gjuhën shqipe dhe serbe, pasuar me debate për lidhjen midis dhunës mbi baza gjinore, të drejtave pronësore dhe ndikimit të pandemisë tek gratë dhe vajzat. Më 8 mars 2021, me rastin e Ditës ndërkombëtare të gruas, Përfaqësuesi Special theksoi kontributin e rëndësishëm të grave në reagimin ndaj pandemisë COVID-19 dhe përpjekjet e tyre për rimëkëmbje, ku theksoi rëndësinë e pjesëmarrjes dhe udhëheqjes domethënëse të grave në vendimmarrje, në hartimin e politikave dhe zbatimin e tyre në të gjitha nivelet.

48. Institucionet e Kosovës vazhduan të ndërmarrin hapa të rëndësishëm për të mbrojtur të drejtat e grave. Më 25 shtator 2020, Kuvendi i Kosovës miratoi legjislacionin për përfshirjen në kushtetutë të dispozitave të Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje ("Konventa e Stambollit"). Përfaqësuesi Special e mirëpriti legjislacionin si një hap të rëndësishëm në avancimin e të drejtave të grave dhe arritjen e një shoqërie të drejtë dhe paqësore. Më 25 nëntor, qeveria miratoi gjithashtu një politikë që synon parandalimin dhe sanksionimin e ngacmimit seksual në institucionet e administratës publike në Kosovë.

IX. Ndërtimi i besimit, partneritetet dhe bashkëpunimi

49. UNMIK-u, në bashkëpunim të ngushtë me ekipin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, vazhdoi të mbështesë avancimin e besimit të ndërsjellë midis komuniteteve të Kosovës dhe përpjekjet për të arritur qëllimet kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm. Në shtator, UNMIK-u, në bashkëpunim me IOM-in, filloi fazën e tretë të një iniciative për ndërtimin e besimit për të promovuar mësimin e të dy gjuhëve zyrtare në Kosovë, duke zgjeruar fjalorin shqip-serbisht dhe serbisht-shqip, duke zhvilluar një kurs të gjuhës në internet dhe duke promovuar të mësuarit e termave në lidhje me pandeminë COVID-19 përmes mediave sociale. Kombet e Bashkuara, OSBE-ja dhe partnerë të tjerë, së bashku me Ministrinë e Arsimit të Kosovës, gjithashtu mbështetën akreditimin e një programi universitar për mësimin e gjuhëve zyrtare. Në janar, me ndihmën e Kombeve të Bashkuara, 73 përkthyesit e punësuar nga sistemi gjyqësor filluan kurse në internet si pjesë e përpjekjes për të siguruar qasje të barabartë në shërbime dhe informacione në të dy gjuhët, në shqip dhe serbisht.
50. Qendra e ndihmës juridike e Institutit të Kosovës për Drejtësi e mbështetur nga UNMIK-u, e cila gjatë periudhës raportuese ofroi ndihmë juridike falas për 754 individë të cenueshëm (275 femra dhe 479 meshkuj) për çështje që lidhen me pronën, punën dhe të drejtat e pensionistëve si dhe dhunën në familje, në nëntor ka shtrirë mbështetjen e saj në komunat e veriut të Kosovës me hapjen e një dege në Mitrovicë. Si pjesë e një projekti të financuar nga UNMIK-u, Nisma për Drejtësi dhe Barazi, një organizatë joqeveritare e Kosovës, nisi një studim mbi qasjen e grave në drejtësi në Ballkanin Perëndimor.
51. Në dhjetor, UNMIK-u mori pjesë në takimin e parë të Grupit koordinues ndërmnistror të Kosovës për të drejtat e njeriut, për të diskutuar çështje lidhur me përkrahjen e të drejtave të njeriut gjatë pandemisë, dhe për të shqyrtuar një projektprogram dhe plan veprimi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Ky Mision gjithashtu organizoi punëtori dhe trajnime virtuale për organizatat vendore të shoqërisë civile, për të mbështetur hartimin e raportit të tyre të dytë të përbashkët mbi situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë me fokus në ndikimin e COVID-19 në të drejtat ekonomike, sociale, kulturore dhe të drejtat e tjera.

52. Misioni vazhdoi të sigurojë mbështetje për një qendër pritëse në Prishtinë, për t'u siguruar fëmijëve të pastrehë dhe familjeve të tyre shërbime të integruara psiko-sociale, arsimore dhe këshilluese përmes internetit, si dhe ushqim, dezinfektues dhe maska fytyre. UNMIK-u ka përshtatur aktivitetet e tij për edukimin mbi të drejtat e njeriut për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me ndikimin e pandemisë në realizimin e të drejtave ekonomike dhe sociale.
53. Përmes aktiviteteve të tij programore, UNMIK-u gjithashtu mbështeti autoritetet qendrore dhe lokale të Kosovës, grupet rinore shumetnike, gratë që jetojnë në strehimore për dhunën në familje dhe pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, për të reaguar ndaj krizës COVID-19. Në dhjetor, UNMIK-u, në bashkëpunim me agjencitë e Kombeve të Bashkuara dhe organizatat e tjera ndërkombëtare, kryen një vlerësim të përbashkët të nevojave që çoi në shpërndarjen e ndihmës humanitare për komunitetin rom në nevojë në Mitrovicën e Jugut. Misioni gjithashtu mbështeti një organizatë joqeveritare rinore shumetnike dhe Këshillin Danez për Refugjatë, në angazhimin e të rinjve nga komuniteti ashkali, egjiptas dhe rom të Kosovës në prodhimin e pajisjeve mbrojtëse personale. Përveç kësaj, UNMIK-u financoi një projekt të prodhimit dhe shpërndarjes së maskave të ripërdorshme për të mbështetur fuqizimin ekonomik të grave që jetojnë në strehimore për viktimat e dhunës në familje.
54. Përmes programit të tij për rininë, për paqen dhe sigurinë, UNMIK-u bëri partneritet me UNICEF-in për të mbështetur gjashtë iniciativa rinore shumetnike mbi qasjen në arsim, përfshirjen e të rinjve me aftësi të kufizuara, të drejtat gjuhësore dhe leximin e medias digjitale. Për të shënuar 5 vjetorin e Rezolutës 2250 (2015) të Këshillit të Sigurimit për rininë, paqen dhe sigurinë, Misioni organizoi aktivitete në internet që bashkuan studentët e Kosovës me lëvizjet e paqes për të rinjtë në rajon, si dhe në Indi, Kolumbi dhe Federatën ruse, për të shkëmbyer praktikat më të mira të pjesëmarrjes së të rinjve në ndërtimin e komuniteteve paqësore dhe gjithëpërfshirëse. Përmes një programi të mbështetur nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për ndërtimin e paqes, përpjekjet vazhduan të kapërcejnë narrativat e konflikteve dhe paragjykimet, duke angazhuar të rinj nga komunitetet e ndara për çështjet me interes të përbashkët. Në dhjetor, si pjesë e programit, filluan një sërë punëtorish mentorimi për gratë e reja udhëheqëse të ardhshme në sipërmarrësi shoqërore, në komunikim, udhëheqje dhe në aspektin e grave si pjesë përbërëse të fuqisë punëtore.
55. Në dhjetor, ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë finalizoi Kornizën e Kombeve të Bashkuara për bashkëpunim dhe zhvillim të qëndrueshëm për vitet 2021-2025. Korniza e bashkëpunimit përfaqëson vizionin kolektiv të agjencive, të fondeve dhe programeve të Kombeve të Bashkuara për të adresuar, së bashku me partnerët qeveritarë, sfidat e zhvillimit në Kosovë. Ajo përfshin planin për reagim socio-ekonomik ndaj COVID-19, i cili po zbatohet nga ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

56. UNMIK-u vazhdoi të ofrojë shërbime të certifikimit të dokumenteve me mbi 2154 dokumente të përpunuara në lidhje me pensionet dhe statusin civil. UNMIK-u lehtësoi lëshimin e 34 njoftimeve të kuqe, 1 njoftimi të verdhë dhe 4 kërkesave për ekstradim nga anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (INTERPOL) në Kosovë. Gjithashtu hapi 816 lëndë për hetim brenda bazës së të dhënave të INTERPOL-it. Duke marrë parasysh numrin e rasteve të përpunuara dhe të mbyllura, mbetet një numër i përgjithshëm prej 743 lëndëve të hapura në lidhje me territorin ose popullin e Kosovës.

X. Vrojtimet

57. Unë përgëzoj institucionet e Kosovës, subjektet politike dhe votuesit për zhvillimin e rregullt të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në shkurt. Pavarësisht nga sfidat e paraqitura nga pandemia, këto zgjedhje dëshmuar një pjesëmarrje më të lartë të votuesve krahasuar me zgjedhjet e tetorit të vitit 2019. Së këndejmi, i inkurajoj udhëheqësit e Kosovës që të përfitojnë nga ky moment dhe të punojnë drejt konstituimit të Kuvendit dhe Qeverisë së re, dhe të zgjedhin Presidentin e Kosovës, brenda afateve të përcaktuara. Unë gjithashtu i bëj thirrje qeverisë së ardhshme të Kosovës dhe opozitës që të punojnë në mënyrë konstruktive për të adresuar ndikimin e pandemisë në popullsinë dhe ekonominë e Kosovës, që të vazhdojnë përpjekjet për të konsoliduar sundimin e ligjit, për të luftuar korrupsionin, për të mbështetur kornizat dhe parimet e të drejtave të njeriut, dhe për t'u angazhuar plotësisht në procese të rëndësishme të nivelit të lartë politik, siç është Dialogu i përkrahur nga Bashkimi Evropian.

58. Unë mirëpres nivelin e lartë të pjesëmarrjes së grave dhe të rinjve në zgjedhje dhe rritjen e përqindjes së grave deputete të zgjedhura në numra që tejkalojnë kuotën e përcaktuar prej 30 për qind. Liderhipi i grave dhe pjesëmarrja e tyre në të gjitha sferat është thelbësore për ndërtimin e një shoqërie më paqësore, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Siç ka treguar kriza globale shëndetësore në vazhdimësi, megjithëse të prekura në mënyrë disproporcionale, gratë vazhdojnë të jenë në ballë të reagimit dhe planifikimit të rimëkëmbjes nga COVID - 19. Në këtë drejtim, kontributi dhe ndikimi i grave udhëheqëse të zgjedhura dhe të emëruara në vendimmarrje në të gjitha nivelet do të jetë thelbësor.

59. Paqja e vazhdueshme, stabiliteti dhe zhvillimi socio-ekonomik në Kosovë dhe rajon varen nga progresi i qëndrueshëm i dialogut që synon normalizimin e marrëdhënieve me Beogradin. Përderisa mirëpres deklaratat e qarta të dhëna nga të dy palët në lidhje me rëndësinë e avancimit të dialogut, unë theksoj rëndësinë e angazhimit të vërtetë për të vazhduar bisedimet e nivelit të lartë brenda kornizës së dialogut Beograd-Prishtinë të mbështetur nga Bashkimi Evropian, në një të ardhme shumë të afërt. Siç është konfirmuar nga Bashkimi Evropian, përparimi në dialog mbetet gjithashtu thelbësor në aspiratat përkatëse të palëve për Bashkimin Evropian.

60. Gjithashtu u bënë hapa të rëndësishëm për të çuar përpara proceset hetimore dhe gjyqësore të Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës dhe Dhomave të Specializuara të Kosovës. Këto institucione të sundimit të ligjit duhet të kenë bashkëpunim të plotë me të gjitha palët që ato të mund të kryejnë në mënyrë efektive detyrat e tyre.

61. Si kudo në botë, Kosova vazhdon të përballlet me krizën COVID-19. Misioni dhe ekipi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë janë të përkushtuar të mbështesin përpjekjet e tyre për të mbështetur institucionet shëndetësore publike dhe popullin e Kosovës në menaxhimin e pandemisë. Ndërsa vaksinat po shpërndahen, Kombet e Bashkuara do të vazhdojnë të mobilizojnë mbështetjen ndërkombëtare për t'u siguruar që ato janë në dispozicion për të gjithë. KB-ja mbetet njëloj e angazhuar në përkrahjen e fushatave të informimit publik, fuqizimin e grave dhe të rinjve për të marrë pjesë në veprime parandaluese, si dhe në ofrimin e ndihmës për komunitetet në nevojë në gjithë Kosovën. Tani është koha për solidaritet dhe bashkëpunim ndërkombëtar dhe KB-ja do të qëndrojë pranë popullit të Kosovës për të identifikuar dhe mbështetur një rrugëdalje nga kriza.

62. Kombet e Bashkuara mbeten të përkushtuara në mbështetjen e komunitetit ashkali, egjiptas dhe rom të prekur nga helmimi me plumb në Kosovë. Duke shprehur keqardhje për mungesën e kontributeve vullnetare në fondin e besimit të Kombeve të Bashkuara, të krijuar për të siguruar këto komunitete me ndihmën e nevojshme, unë përsëri u bëj thirrje shteteve anëtare, palëve dhe organizatave të tjera të respektojnë përgjegjësinë tonë të përbashkët dhe të kontribuojnë në këtë fond.

63. Falënderoj Përfaqësuesin tim Special, Zahir Tanin, për udhëheqjen e tij dhe të gjithë stafin e Misionit për përkrahjen e tyre të përkushtuar për Kosovën, përfshirë edhe përmbushjen e sfidave të pandemisë. Unë ritheksoj mirënjohjen time për Koordinatorin e Kombeve të Bashkuara për zhvillim dhe për agjencitë, fondet dhe programet e Kombeve të Bashkuara për kontributin dhe bashkëpunimin e tyre të paçmuar me UNMIK-un, si dhe për partnerët e kahmotshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, duke përfshirë Forcën e Kosovës, Bashkimin Evropian dhe OSBE-në.

Shtojca I.

Raporti i Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm mbi aktivitetet e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, nga 16 shtatori 2020 deri më 15 mars 2021.

1. Përmbledhje

Më shumë se dy vjet pas përfundimit të mandatit ekzekutiv të Misionit në fushën e drejtësisë, monitorimi intensiv i lëndëve të proilit të lartë për korrupsion, për krim të organizuar dhe krime lufte, përfshirë ish-rastet e EULEX-it, ka dëshmuar të jetë një mënyrë e suksesshme dhe efektive për të ndërtuar trashëgiminë ekzekutive të Misionit dhe për t'u ofruar homologëve të Kosovës këshilla përkatëse mbi çështjet sistematike dhe çështjet e lëndëve specifike. Për më tepër, monitorimi intensiv ofron një pasqyrë unike në punën e brendshme të gjyqësorit të Kosovës.

Në tetor të vitit 2020, EULEX-i filloi raportin e parë publik të monitorimit të drejtësisë së bashku me partnerët e tij kryesorë të Kosovës në gjyqësor. Duke pas parasysh rëndësinë e sundimit të ligjit, veçanërisht në lidhje me rrugën evropiane të Kosovës, ishte koha të bëheshin të disponueshme për publikun më të gjerë rezultatet e punës monitoruese të EULEX-it, përfshirë organizatat e shoqërisë civile për sundimin e ligjit, të cilët vetë janë të angazhuar në monitorimin e gjyqësorit, avokatëve dhe praktikantëve të tjerë ligjorë, si dhe qytetarëve të interesuar. Raporti u prit mirë dhe homologët e tyre të Kosovës kanë mbështetur dhe ndjekur disa nga gjetjet dhe rekomandimet e Misionit.

EULEX-i vazhdoi të ofrojë mbështetje operacionale dhe logjistike për Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe për Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Mbështetur nga EULEX-i dhe Policia e Kosovës, Zyra e Prokurorit të Specializuar, më 4 dhe 5 nëntor të vitit 2020, zhvilloi operacione që çuan në arrestimin e ish-Presidentit Thaçi dhe disa udhëheqësve të tjerë të shquar politikë.

Gjatë zgjedhjeve të jashtëzakonshme parlamentare më 14 shkurt të vitit 2021, EULEX-i vendosi stafin në vendkalimet e përbashkëta ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, për të monitoruar fluksin e parashikuar të votuesve nga Serbia, dhe gjithashtu në cilësinë e tij si përgjegjësi i dytë i sigurisë, Misioni vuri në gatishmëri Njësinë e tij të formuar të Policisë të jetë në gjendje të reagojë shpejt në rast nevojë.

2. Monitorimi

Misioni vazhdoi aktivitetet e tij për monitorimin e lëndëve. Prania fizike në gjykata dhe takimet me policinë, me prokurorinë dhe gjyqtarët u kryen kurdoherë që ishte e mundur dhe në përputhje me kufizimet e zbatueshme COVID-19. Marrëdhëniet e vendosura prej kohësh të besimit me të

gjithë homologët vendas siguruan që vëzhguesit e Misionit të ishin mirë të informuar për të gjitha zhvillimet në çdo kohë, edhe kur kontaktet kufizoheshin në thirrje telefonike dhe videothirrje.

Në veçanti, Misioni monitoroi nga afër ndikimin e një dispozite të Kodit të Procedurës Penale, e cila përcakton që gjykimet duhet të fillojnë sërish nëse nuk është mbajtur seancë dëgjimore për tre muaj rresht. Për shkak të kufizimeve nga COVID-19 dhe zvogëlimit të përgjithshëm të numrit të seancave gjyqësore, efekti i këtij rregulli bëri që një numër gjykimesh të rinisnin. Derisa ky rregull deri më tani është anashkaluar në shumë raste, duke bërë që të dy palët të pajtohen të marrin në konsideratë dëshmitë e mëparshme si të lexuara dhe të vazhdojnë procedurën, kjo qasje nuk është në përputhje me ligjin dhe mund të konsiderohet si arsye për ankesë në një fazë të mëvonshme të gjykimit, me efekte të dukshme negative lidhur me ndarjen në kohë të drejtësisë.

Që nga fillimi i punës së saj, Njësia për monitorimin e lëndëve ka hartuar katër raporte sistematike dhe tematike me rekomandime specifike për gjyqësorin e Kosovës. Tre raportet e para u ndanë dhe u diskutuan vetëm me homologët vendas dhe me partnerët përkatës ndërkombëtarë. Sidoqoftë, raporti i katërt, i finalizuar në tetor të vitit 2020, iu prezantua publikut të gjerë, duke marrë vëmendjen e gjerë dhe të favorshme të mediave dhe ekspertëve (<https://www.eulex-kosovo.eu/?page=2,11,1250>). Disa tendenca dhe modele të identifikuara në këtë raport janë trajtuar nga homologët vendorë, për shembull përqindja e lartë e seancave joproduktive dhe praktika e caktimit të lëndëve me profil të lartë të njëjtit panel gjykatësish. Një nga rekomandimet e raportit ishte forcimi i grupit veprues kundër korrupsionit të Policisë së Kosovës, të cilën Qeveria vendosi ta shpërbëjë pikërisht në ditën kur u prezantua raporti i Misionit. Vlerësimi specifik i EULEX-it në raport dhe njohuritë e thella të Misionit për grupin veprues kundër korrupsionit, luajtën një rol të madh në ndërhyrjen e suksesshme të përbashkët nga familja e BE-së dhe bashkësia e gjerë ndërkombëtare për ta kthyer këtë vendim.

Misioni gjithnjë e më shumë po perceptohet nga partnerët lokalë si një mbrojtës kundër ndikimit të padrejtë dhe ndërhyrjes politike në gjyqësor, e cila është akoma e zakonshme në Kosovë. Në disa raste, zyrtarët policorë, prokurorët dhe gjykatësit kanë kërkuar nga Misioni që ai të monitorojë lëndët, dhe disa herë edhe hetimet.

Gjatë vitit të kaluar, EULEX-i ndihmoi Njësinë për hetimin e krimeve të luftës të Policisë së Kosovës, në krijimin e suksesshëm të një baze elektronike të të dhënave të krimeve të luftës. Baza e të dhënave është një mjet i rëndësishëm për administrimin e lëndëve penale komplekse, dhe gjithashtu mundëson analiza cilësore të lëndëve. Krijimi i bazës së të dhënave ka rezultuar në një bashkëpunim të shtuar midis Prokurorisë Speciale dhe Njesisë për hetimin e krimeve të luftës, ndërsa ndihmon gjithashtu në ruajtjen e trashëgimisë së EULEX-it në lëndët e krimeve të luftës të trajtuara gjatë mandatit të tij ekzekutiv në drejtësi. Krijimi i bazës së të dhënave u vlerësua pozitivisht nga palët e tjera ndërkombëtare në Kosovë, duke rezultuar në mbështetje të mëtejshme Njesisë për hetimin e krimeve të luftës.

Përveç kësaj, Misioni dha komente mbi disa projektligje dhe strategji të lidhura me sundimin e ligjit përmes Mekanizmit të rishikimit legjislativ të udhëhequr nga PSBE.

Misioni i përshtati aktivitetet e tij të monitorimit në objektet e Shërbimit Korrektues të Kosovës me kufizimet lidhur me pandeminë, ndërsa mbante kontakte të rregullta me drejtorinë e Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe të gjitha njëmbëdhjetë institucionet korrektuese në mënyrë që të ishte në gjendje të vlerësonte mënyrën se si Shërbimi Korrektues i Kosovës po menaxhonte sfidat e reja të paraqitura nga COVID-19. Vëmendje e veçantë iu dha sigurimit se masat kufizuese lidhur me pandeminë në institucionet korrektuese janë në përputhje me udhëzimet ndërkombëtare dhe evropiane për respektimin e të drejtave të njeriut dhe trajtimin e kategorive specifike të të burgosurve, siç janë të burgosurit e profilit të lartë ose të radikalizuar. Vizitat personale në të gjitha objektet u rifilluan sa më shpejt që u bë e mundur. Ekspertët e misionit ndanë në baza të rregullta me drejtorinë e Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe drejtorët e të njëmbëdhjetë institucioneve vëzhgimet dhe rekomandimet e tyre se si të merren më mirë me kufizimet lidhur me pandeminë.

Misioni vazhdoi të promovojë dhe mbështesë krijimin e një mekanizmi të vlerësimit të rrezikut dhe nevojave për të burgosurit e dënuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Në përputhje me praktikën më të mirë evropiane, sipas së cilës po i kushtohet një rëndësi e madhe rehabilitimit të të burgosurve dhe parandalimit të kryerjes së një krimi tjetër. Ky mekanizëm siguron bazën për një praktikë sistematike të planifikimit të dënimit. Brenda kësaj kornize, Misioni mbrojti, përkrahu dhe ofroi ekspertizë për krijimin e Njesisë për vlerësimin dhe klasifikimin e të burgosurve për të burgosurit e dënuar. EULEX-i organizoi disa masa trajnuese mbi vlerësimin e rrezikut dhe nevojave për stafin e Njesisë për vlerësimin dhe klasifikimin e të burgosurve bazuar në parimet e sensibilitetit ndaj rrezikut dhe nevojës, dhe zhvilloi vizita studimore në Finlandë dhe Suedi. Për më tepër, Misioni identifikoi mungesën e një baze gjithëpërfshirëse të të dhënave si një pengesë serioze për funksionimin e sistemit të vlerësimit. EULEX-i më pas e bleu shërbimin për përditësimin e bazës së të dhënave të të burgosurve, i cili po përdoret me sukses për gjenerimin e të dhënave dhe raporteve të nevojshme. Si rezultat, informacioni i të burgosurit, vlerësimi dhe plani individual i dënimit tani mund të ndahen, zbatohen dhe ndiqen lehtësisht.

Me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit për nevojën e rritjes së numrit të grave në Shërbimin Korrektues të Kosovës, përfshirë edhe në pozita drejtuese, EULEX-i përkrahu punën e Shoqatës së Grave të Shërbimit Korrektues të Kosovës, duke ofruar kurse trajnimi në internet dhe duke lehtësuar kontaktet e Shoqatës me palët përkatëse vendore dhe ato ndërkombëtare, si dhe me shoqata të ngjashme në mbarë botën. Misioni identifikoi disa mangësi të rëndësishme në nivelin e aftësive dhe kapaciteteve profesionale brenda Shërbimit Korrektues të Kosovës, si dhe mangësi në procedurat e vendosura. Janë realizuar disa seminare trajnimi për të adresuar disa nga boshllëqet, siç janë parimet e vlerësimit të rrezikut dhe sigurisë. U adresuan dy shqetësime kryesore: 1) procedurat për trajtimin e të burgosurve me probleme të shëndetit mendor dhe 2) veprimet që duhen ndërmarrë në rastet e vetëvrasjes dhe vetëdëmtimit. Ekspertët e Misionit ofruan këshilla për hartimin e një plani emergjence për rastet e vetëvrasjes dhe vetëdëmtimit në të gjitha objektet e Shërbimit Korrektues të Kosovës, dhe zhvilluan trajnime për stafin e Shërbimit Korrektues të Kosovës të identifikuar si trajnerë të ardhshëm, të cilët më pas ofruan trajnime për stafin e gjerë të Shërbimit Korrektues të Kosovës se si të merren me raste të tilla në përputhje me planin e emergjencës. Stafi i EULEX-it po merr pjesë në të gjitha sesionet trajnuese me qëllim që të ofrojë ndihmë ose sqarime të mëtejshme. Ky aktivitet është në vazhdim e sipër.

Në mbështetje të Përfaqësuesit Special të BE-së për Dialogun Beograd-Prishtinë dhe çështje të tjera rajonale të Ballkanit Perëndimor, ekspertët e Misionit vazhduan të lehtësojnë zbatimin e Protokollit Teknik të MIK të arritur si pjesë e Dialogut Beograd-Prishtinë të mbështetur nga BE-ja. Pa pasur asnjë komunikim zyrtar midis dy palëve në gjashtë vendkalimet e përbashkëta, Misioni siguroi një kanal thelbësor dhe të rregullt të komunikimit në nivelin teknik përmes vizitave të tij të rregullta në vendkalimet e përbashkëta dhe kontakteve me të dy grupet e autoriteteve. Në tetor, Misioni lehtësoi dhe koordinoi negociatat teknike për përgatitjen e lëvizjes së stafit të palës së Beogradit në lokacionet e reja të dedikuara për ata, në vendkalimin e përbashkët kryesor në Merdare, të ngjashme me atë të homologëve të tyre në Prishtinë, të cilët tashmë po i përdorin plotësisht këto lokacione të tyre.

Gjatë pandemisë, roli i Misionit në marrjen e informacionit të saktë dhe në kohë reale për të gjitha situatat e dhëna në vendkalimet e përbashkëta u bë rol thelbësor, në mënyrë që t'i kundërvijë dezinformimit. Kjo ishte e mundur falë rrjetit të kontakteve të kahmotshme dhe të besueshme të EULEX-it me të dy palët dhe njohjes së thellë të rrethanave specifike në të gjitha vendkalimet e përbashkëta. Informacioni gjithashtu ndahej rregullisht me palët relevante të BE-së, si dhe me organizatat e tjera ndërkombëtare në Kosovë.

Për më tepër, lehtësimi i ndërmarrë nga Misioni dhe ekspertiza e tij ishin thelbësore në shtyrjen përpara të disa zhvillimeve të rëndësishme lidhur me MIK. Këto përfshinin funksionalizimin e plotë të një "Qendre kombëtare për menaxhimin e kufirit" të nivelit të lartë, një model për të gjithë rajonin që është në përputhje me Nismën primare përkatëse të përfshirë në Strategjinë e Ballkanit Perëndimor 2018, të hartuar nga Komisioni Evropian, përmes së cilës bëhet thirrje për krijimin e qendrave të ngjashme në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor për t'i lidhur ato përmes një rrjeti rajonal për shkëmbimin e informacionit. Për më tepër, EULEX-i luajti një rol qendror në hartimin e "Strategjisë Kombëtare të MIK dhe Planit të Veprimit (2020-2024)", dhe në arritjen e marrëveshjes që strategjia të jetë një dokument i pavarur me një buxhet të dedikuar. Të dy dokumentet u miratuan përfundimisht nga Kryeministri në detyrë në shkurt të vitit 2021. EULEX-i gjithashtu ndihmoi në lehtësimin e shkëmbimit të informacionit midis administratave doganore të të dy palëve, pas ankesave të komunikuar nga Sekretariati i Marrëveshjes për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore mbi kërkesat në pritje. Kjo u bë përmes një mekanizmi të vendosur brenda kornizës së dialogut të lehtësuar nga BE-ja.

Misioni vazhdoi të punojë me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe me Agjencinë e Regjistrimit Civil, në procesin e përmbushjes së kërkesave për të cilat u pajtuan në marrëveshjet teknike të lirisë së lëvizjes të përkrahura nga BE-ja, dhe në zbatimin e tyre. Ky ka qenë një proces i ngadaltë dhe i rëndë duke pas parasysh kompleksitetin e këtyre marrëveshjeve, si dhe vështirësitë dhe vonesat që rezultojnë nga ndryshimet e shpeshta të qeverive në Kosovë gjatë vitit të kaluar. Misioni ndihmoi dhe këshilloi Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Agjencinë e Regjistrimit Civil në hartimin e udhëzimeve administrative dhe vazhdimin e vendimeve ministrore, që synojnë lehtësimin e njohjes së dokumenteve dhe sigurimin e përjashtimit nga taksat për regjistrimin e automjeteve për serbët e Kosovës. Njohja e dokumenteve të lëshuara nga autoritetet serbe (certifikatat e lindjes, martesës dhe vdekjes, patentë shoferi) nga autoritetet e Kosovës dhe lehtësimi i regjistrimit të automjeteve me targa KS ose RKS për pronarët e automjeteve me RFJ ose targa të ngjashme, mbeten të një rëndësie të madhe për të siguruar liri të vërtetë të lëvizjes, kryesisht por jo ekskluzivisht për popullatën serbe të Kosovës.

Përveç kësaj, me kërkesë të tij Misioni siguroi vlerësime për ekipin e PSBE-së për Dialogun Beograd-Prishtinë dhe çështje të tjera rajonale të Ballkanit Perëndimor, mbi situatën në vendkalimet e përbashkëta midis Kosovës dhe Serbisë në lidhje me përdorimin e dokumenteve përkatëse (pasaportat, letërnjoftimet, patentat e shoferit, certifikatat e regjistrimit të automjeteve, dokumentet e hyrjes / daljes).

EULEX-i vazhdoi të këshillojë dhe mentorojë kryetarin e Gjykatës themelore të Mitrovicës dhe shefin e divizionit të Gjykatës së Apelit në Mitrovicë si dhe autoritetet e tjera gjyqësore, në mënyrë që të sigurojë mbështetje në zbatimin e Marrëveshjes së Parë të Brukselit mbi parimet që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve, dhe në zbatimin e Marrëveshjes për Drejtësi, si dhe me qëllim që të sigurohet vendosja e plotë e mekanizmave të sundimit të ligjit në komunat veriore në Kosovë. Përveç kësaj, EULEX-i ndoqi nga afër zhvillimet në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës, Gjykatën Supreme, Gjykatën e Apelit dhe Ministrinë e Drejtësisë, të cilat patën një ndikim në zbatimin e suksesshëm të marrëveshjeve të lartpërmendura.

Me kërkesë të Ministrit të Drejtësisë, Misioni ofroi këshilla mbi opsionet për të kapërcyer ngërçin në përbërjen e paneleve me shumicë serbe në Departamentin special të Gjykatës së Apelit, i cili merret me çështje të profilit të lartë. EULEX-i gjithashtu siguroi ekspertizë mbi marrëveshjen që synonte të siguronte njohjen nga sistemi juridik i Kosovës të dokumenteve ligjore të gjykatave paralele serbe, deri në një datë të caktuar të ndërprerjes.

2. Operacionet

Funksionet operacionale janë ndërmarrë nga Shtylla e Operacioneve të Misionit, e cila ruan disa kompetencat të kufizuara si reaguese e dytë e sigurisë, dhe ofron mbështetje të vazhdueshme për Policinë e Kosovës në kontrollimin e turmave dhe trazirave përmes këshillave dhe trajnimeve të përbashkëta. Mekanizmi trenivelësh i përgjegjësisë për sigurinë në Kosovë përbëhet nga Policia e Kosovës si e para, EULEX-i si e dyta dhe KFOR-i si përgjegjësi i tretë i sigurisë.

EULEX-i vendosi vëzhgues në vendkalimet e përbashkëta kryesore ditën e zgjedhjeve (14 shkurt), për të ndjekur raportimet për një rritje të pritshme të trafikut, me votuesit serbë të Kosovës që vijnë nga Serbia. Dita kaloi pa incidente. Një zyrtar ndërlidhës i operacioneve ishte vendosur në selinë operative të Policisë së Kosovës, për të ndjekur zhvillimet në lidhje me sigurinë në ditën e zgjedhjeve dhe për të siguruar një qarkullim të qetë të informacionit.

Misioni mbështeti Institutin e Mjekësisë Ligjore të Kosovës në zhvarrosjen e eshtrave njerëzore nga varrezat në komunën e Pejës dhe të Mitrovicës, ku u gjetën eshtra të plota të viktimave potencialisht të lidhura me konfliktin, duke përfshirë dy grupe eshtrash në një varrezë të Mitrovicës.

EULEX-i ofroi mbështetje për aktivitetet kryesore të Institutit të Mjekësisë Ligjore të Kosovës në punën e tij të specifike për personat e zhdukur. Më 16 nëntor të vitit 2020, ekspertë nga EULEX-i, nga Komisioni qeveritar serb për personat e zhdukur dhe nga Instituti i Mjekësisë Ligjore të Kosovës, zbuluan eshtra njerëzore në Kizhevak, një lokacion i madh guror në Serbi. Misioni ka punuar që nga viti 2015 në Kizhevak në kërkim të eshtrave njerëzore, dhe ekspertët mjekoligjorë të EULEX-it më në fund identifikuan zonën e saktë, duke krahasuar fotot ajrore, duke ngushtuar kërkimin në koordinata specifike, që çuan në zbulimin e mbetjeve njerëzore. Ekspertët e Misionit do të vazhdojnë të ofrojnë ndihmë pasi punimet e zhvarrosjes pritet të rinisin në pranverë.

EULEX-i vazhdoi mbështetjen e tij për Policinë e Kosovës në fushën e bashkëpunimit policor ndërkombëtar. Megjithatë Kosova nuk është anëtare e Interpol-it, EULEX-i lehtëson shkëmbimin e informacionit midis Njësisë së Policisë së Kosovës për bashkëpunim ndërkombëtar në zbatim të ligjit dhe zyrave qendrore nacionale të Interpolit nën ombrellën e Misionit të KB-së në Kosovë. EULEX-i gjithashtu vazhdoi të lehtësojë shkëmbimin e informacionit ndërmjet Europol-it dhe Policisë së Kosovës mbi hetimet e krimeve të rënda, përmes zyrës së tij ndërlidhëse Europol si dhe midis Policisë së Kosovës dhe autoriteteve serbe, në përputhje me Protokollin përkatës midis EULEX-it dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë. Gjatë periudhës raportuese, vëllimi i kërkesave për shkëmbim informacioni të lehtësuar nga EULEX-i sipas këtij Protokolli shënoi një rritje të konsiderueshme.

EULEX-i vazhdoi të mbështesë Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar në përputhje me legjislacionin përkatës të Kosovës. Më 24 dhe 25 shtator, Misioni ofroi mbështetje operationale dhe logjistike për Zyrën e Prokurorit të Specializuar në kryerjen e arrestimeve të tre personave, dhe në operationet e kërkimit në mjediset e Shoqatës së veteranëve të luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Prishtinë. Mbështetur nga EULEX-i dhe Policia e Kosovës, Zyra e Prokurorit të Specializuar, më 4 dhe 5 nëntor, zhvilloi operatione të mëtejshme që çuan në arrestimin e ish-Presidentit Thaçi dhe tri figurave të tjera të shquara politike. Arrestimet u bënë nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, në përputhje me urdhërarrestet, urdhrat e transferimit dhe aktakuzat e konfirmuara të lëshuara nga një gjyqtar i procedurës paraprake të Dhomës së Specializuar të Kosovës.

Shtojca II.

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar

Gjatë kësaj periudhe raportuese, veprimtaria gjyqësore publike u rrit ndjeshëm me arrestimin dhe transferimin në qendrën e paraburgimit të Dhomave të Specializuara (DhS) të shtatë të akuzuarve në shtator dhe nëntor. Pavarësisht nga pandemia COVID-19, DhS mbajtën 18 seanca dëgjimore gjatë periudhës raportuese, në të cilat morën pjesë palët, personalisht dhe përmes videokonferencave. Në procedurën gjyqësore publike, që përfshinte tre lëndë në fazën paraprake, u pa angazhimi i gjyqtarit të procedurës paraprake, i cili lëshoi më shumë se 120 vendime dhe urdhra gjatë periudhës raportuese, si dhe angazhimi i kolegjit të Gjykatës së Apelit. Një panel i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Kushtetuese (DhPGjK) ishte gjithashtu i angazhuar gjatë periudhës së raportimit.

Më 17 shtator, autoriteti emërtues, me rekomandim të Panelit të pavarur të përzgjedhjes, caktoi gjashtë gjyqtarë të rinj në listën e gjyqtarëve ndërkombëtarë në përputhje me nenin 28 (4) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji).

Më 23 shtator, sekretari, në konsultim me kryetaren e DhS miratoi Rregulloren për paraburgim dhe udhëzimet për praktika të ngjashme, të cilat rregullojnë vizitat e të burgosurve dhe komunikimet midis të burgosurve dhe avokatit të tyre dhe familjeve të tyre, dhe përfshijnë një regjim disiplinor dhe procedurën e ankesës.

Më 24 shtator, z. Salih Mustafa, i cili është akuzuar me katër akuza për krime të luftës, u arrestua në Kosovë dhe u transferua në qendrën e paraburgimit të DhS. Më 28 shtator, z. Mustafa ndoqi paraqitjen e tij fillestare para gjyqtarit të procedurës paraprake dhe më 28 tetor, z. Mustafa u deklarua i pafajshëm për të gjitha akuzat kundër tij në aktakuzë.

Më 25 shtator, z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinaj u arrestuan dhe u transferuan në qendrën e paraburgimit të DhS në Hagë më 25 dhe 26 shtator. z. Gucati dhe z. Haradinaj akuzohen për dy akuza për vepra penale kundër rendit publik dhe katër akuza për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike. Më 18 dhjetor, z. Gucati dhe z. Haradinaj morën pjesë në paraqitjen e tyre fillestare para gjyqtarit të procedurës paraprake, gjatë së cilës z. Gucati u deklarua i pafajshëm për të gjitha akuzat kundër tij në aktakuzë. Më 8 janar 2021, gjyqtari i procedurës paraprake bëri një deklaratë pafajësie në emër të z. Haradinajt në përputhje me Rregulloren e procedurës dhe provave, pasi z. Haradinaj nuk arriti të paraqesë një deklaratë.

Më 29 shtator, kryetarja e DhS u paraqit personalisht përpara Komitetit Politik dhe të Sigurisë të Bashkimit Evropian (BE) në Bruksel, gjatë së cilës ajo informoi shtetet anëtare mbi aktivitetet gjyqësore të DhS, u përgjigj pyetjeve të paraqitura nga shtetet dhe diskutoi disa nga sfidat me të cilat aktualisht përballen DHS.

Më 26 tetor, gjyqtari i procedurës paraprake konfirmoi aktakuzën kundër z. Hashim Thaçit, z. Kadri Veselit, z. Rexhep Selimit dhe z. Jakup Krasniqit, i cili ata i akuzon për dhjetë akuza për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Zotërinjtë Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi u arrestuan dhe u transferuan në qendrën e paraburgimit të DhS më 4 dhe 5 nëntor. Gjatë paraqitjeve të tyre fillestare para gjyqtarit të procedurës paraprake më 9, 10 dhe 11 nëntor, të akuzuarit u deklaruan të pafajshëm për të gjitha akuzat kundër tyre në aktakuzë. Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) realizoi arrestimet dhe bastisjet përkatëse në secilin rast me ndihmë dhe mbështetje të konsiderueshme nga EULEX-i si dhe me mbështetje operationale nga Policia e Kosovës.

Më 30 tetor, autoriteti emërtues riemërtoi gjyqtaren Ekaterina Trendafilova si kryetare e DhS për një mandat katërvjeçar, në përputhje me nenin 30 (4) të Ligjit, duke filluar nga data 15 dhjetor.

Në nëntor, sekretari publikoi Strategjinë e DhS kundër mashtrimit, e cila rikonfirmoi angazhimin e fuqishëm të DhS për të zbuluar dhe parandaluar mashtrimin, duke respektuar standardet e rrepta etike, duke nxitur një kulturë të mosmbrojtjes me kundërpadi për sinjalizim, dhe duke përkufizuar qartë e duke ndarë përgjegjësitë për zbatim.

Më 26 nëntor, një panel i DhPGJK gjeti që ndryshimet në Kushtetutë të propozuara nga presidenti i atëhershëm Hashim Thaçi në lidhje me mandatin e DhS dhe ZPS dhe referuar DhS nga Kuvendi i Kosovës, zvogëluan të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës. Paneli i DhPGJK më tej theksoi se një ndryshim në kornizën ligjore të DhS mund të ndërmerret vetëm pas konsultimeve me Bashkimin Evropian, siç parashihet në Shkëmbimin e Letrave të vitit 2014 dhe nenin 162 (13) dhe (14) të Kushtetutës.

Më 9 dhjetor, një panel i Gjykatës së Apelit rrëzoi një ankesë nga z. Gucati në lidhje me vazhdimin e paraburgimit të tij. Më 9 shkurt, një panel i Gjykatës së Apelit mohoi një ankesë nga z. Haradinaj kundër vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake për vazhdimin e paraburgimit të tij. Në kohën e raportimit, një panel i Gjykatës së Apelit po shqyrton ankesat nga katër të akuzuarit në lëndën Thaçi dhe të tjerët, për vendimet e gjyqtarit të procedurës paraprake që mohojnë lirinë e tyre të përkohshëm.

ZPS vazhdoi të intervistojë të dyshuar, viktimat dhe dëshmitarë gjatë periudhës së raportimit, si dhe të mbledhë dhe shqyrtojë prova të tjera. Për të përmbushur mandatin e saj, ZPS vazhdon të kërkojë angazhimin dhe mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare, të organizatave ndërkombëtare dhe shteteve individuale.

Gjatë periudhës raportuese, ekipi i kontaktit zhvilloi mbi 12 ngjarje duke përfshirë të rinjtë, shoqërinë civile, studentët e drejtësisë, gazetarët dhe përfaqësuesit e pakicave në të gjithë Kosovën.

Lista e avokatëve specialist të përshtatshëm të punojnë pranë DhS aktualisht përfshin 203 avokatë, nga të cilët 95 janë të kualifikuar për të përfaqësuar viktimat. Procesi i aplikimit mbetet i hapur. Numri i pyetjeve të mediave të pranuar nga DhS ka vazhduar të rritet që nga fillimi i procedurave publike, dhe raportimi i saktë i mediave është rritur.

Kryetarja, sekretari dhe Prokurori i Specializuar vazhduan angazhimin e tyre me shtetin nikoqir, me shtetet anëtare të BE-së, shtetet kontribuese dhe të tjerët. Gjatë dy ditëve në dhjetor, kryetarët mbajtën konferenca në internet për Zëvendëssekretarin e Përgjithshëm të BE-së, Misionin e BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë, për ambasadorët e shteteve anëtare të BE-së dhe shteteve të treta kontribuese në Kosovë, si dhe për ambasadorët e shteteve anëtare të BE-së dhe shteteve të treta kontribuese në Hagë. Më pas, më 11 shkurt në Hagë, kryetarja dha informacione të përditësuara për shtetet anëtare të BE-së.

Shtojca III

Përbërja dhe numri i komponentës policore të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (deri më 15 mars 2021)

Shteti	Gra	Burra	Numri
Austria	1		1
Bullgaria	1		1
Çekia		1	1
Gjermania		1	1
Federata Ruse	1	2	3
Turqia		1	1
Ukraina		1	1
Gjithsej	3	6	9


Përbërja dhe numri i komponentës ndërlidhëse ushtarake të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (deri më 15 mars 2021)

Shteti	Gra	Burra	Numri
Çekia		2	2
Polonia		1	1
Republika e Moldavisë		1	1
Rumania		1	1
Turqia		1	1
Ukraina	1	1	2
Gjithsej	1	7	8

UNMIK

MARCH 2021

UNITED NATIONS
Geospatial



The boundaries and names shown and the designations used on this map do not imply official endorsement or acceptance by the United Nations.

Map No. 4133 Rev. 86
Mar 2021